

5 maj 2012, Prizren

## KOMUNIKATË PËR MEDIA

### Kryetari i Komunës së Prizrenit pa Plan të punës

EC Ma ndryshe shpreh shqetësimin në lidhje me mungesën Planit të Punës nga ana e Kryetarit të Komunës së Prizrenit. Në kërkesën tonë drejtuar Kryetarit të Komunës për të pasur qasje në Planin Vjetor të Punës për vitin 2012 dhe vendimet e marra që nga fillim viti 2012 dhe mënyra e publikimit të vendimeve të Kryetarit; nga ana e zyrtarëve komunal është marrë përgjigjja se "Raportin e punës së Kryetarit të Komunës dhe vendimet (konkluzionet) e tij mund ta gjeni në ueb e Komunës së Prizrenit".

Fillimisht përgjigjja e parë e kthyer në mënyrë elektronike nuk përkon me kërkesën tonë meqenëse ne kemi kërkuar Planin e Punës së Kryetarit e jo raportet e tij. Nga përgjigjja zyrtare e komunës së Prizrenit konkludohet se Kryetari i komunës nuk ka Plan Vjetor të Punës. Kjo nënkupton se Prizreni qeveriset pa planifikim strategjik dhe në bazë të inercionit të Kryetarit të komunës.

Me qëllim të ngritjes së cilësisë së mirëqeverisjes dhe për të pasur një transparencë me të madhe lidhur me dinamikën e realizimit të objektivave të qeverisë lokale, EC Ma Ndryshe kërkon nga Kryetari i Komunës së Prizrenit që sa më parë të fillojë me hartimin e Planit të Punës për vitin 2012 dhe publikimin e tij për publikun e gjerë.

Sa i përket transparencës së vendimeve të kryetarit të Komunës së Prizrenit; EC Ma Ndryshe publikimin e vendimeve në mënyrë të përgjithësuar e konsideron jo efektiv ngase nuk specifikohen këto vendime se si rezultat të cilave politika kanë ardhë. Pos publikimit të vendimeve në mënyrë të përgjithësuar, Kryetari i Komunës duhet që pa humbur kohë t'i autorizojë drejtorët e drejtorive komunale që vendimet në formë preliminare të publikohen në ueb faqen e komunës. Në këtë mënyrë, qytetarëve u mundësohet që të jenë pjesëmarrës në hartimin e politikave dhe marrjen e vendimeve. Kjo praktikë shkon në favor të transparencës dhe llogaridhënies së ekzekutivit komunal.

Projekti i EC Ma Ndryshes për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe prej muajit maj përmes web-faqes së projektit, ku të gjeturat do të postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit.

Ju falemnderit për bashkëpunimin tuaj,

Hajrulla Çeku, drejtor ekzekutiv  
OJQ EC Ma Ndryshe  
Rr. Ismet J. Kumanova, Nr. 31 - Prizren  
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
+381 38 522 199 & +386 49 116 448